



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Planuar / Doretuar Prmijeno/Prodato Received/Delivery	13.01	2021	1. vit god. year.
Organ /Njësia Organ /Jednica Org. Unit	Hr. Prot Hr. Prot Prot. No.	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHËK	120/2021		1.1.2.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A Nr. 426/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.426/2020, të datës 21.12.2020, të parashtruar nga me adresë banimi Rr.„ Ali Hadri”, Nr. 4, Llamella 4, Komuna e Prizrenit, kundër Vendimit Nr. Prot: 12143 të datës 14.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, në çështjen juridike “ *kontest nga marrëdhënia e punë-transfer*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.01.2021, unanimisht mori këtë;

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.Nr.426/2020 të datës 21.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me Vendimin Nr.10442 të datës 24.09.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës është transferuar nga pozita e Zyrtarit për Zhvillimin e Programit të Patent Shoferëve në Departamentin e Automjeteve, në pozitën e Udhëheqësit të Njesisë së Patentë Shoferëve në Prizren. Ndërsa më datë 14.11.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës me Vendimin Nr.Prot:12143, ka shfuqizuar Vendimin Nr.10442 të datës 24.09.2019, duke kthyer ankuesin në pozitën sipas Ndryshim dhe Plotësim Akt Emërimit të datës 25.07.2016.

I pakënaqur me Vendimin Nr.10442 të datës 24.09.2019, ankuesi me datë 21.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Nr. Prot. 3217/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 24.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministrisë së Infrastrukturës, ndërsa me datë 05.01.2021 Ministria e Infrastrukturës ka dërguar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 17/2021, se bashku me shkresat e lëndës.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 426/2020, e datës 21.12.2020, me numër protokollit 3217/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit Nr. Prot: 12143 të datës 14.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, Vendimi Nr.10442 i datës 24.09.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit të datës 25.07.2016; Përgjigje në ankesë e datës 05.01.2021, kërkesa për tërheqje të ankesës me numër protokollit 17/2021 e datës 08.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga palët, ka konstatuar që të përfundohet procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.Nr.426/2020 të datës 21.12.2020, e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Ankuesi _____ me datë 21.12.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit Nr. Prot: 12143 të datës 14.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, me pretendimin ankimore se ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publike, ndërsa më datë 08.01.2021, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot: 51/2021.për tërheqje të ankesës të parashtruar me datë 21.12.2020.

Pas veprimit administrativ të ankuesit për tërheqje të ankesës, si dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nën 103 paragrafit 1, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, Kolegji për shqyrtimin e ankesës konstaton se është plotësuar baza ligjore për përfundim të procedimit administrativ të filluar me ankesën A. Nr. 426/2020 të datës 21.12.2020, të parashtruar nga ankuesi

Kolegji duke ju referuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nën 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk ndal ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 426/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës
- Arkivit të KPMSHCK-së

Ardita Haxhnikaj – DEMI

Kryetare e Kolegjit